



Pse veto-ja bullgare ishte pretekst dhe pse tani do të na hapen negociatat.

Ilir Aliaj

Ndjekja nga afer e proceseve integruese të Shqipërisë, na ka mesuar që shpesh të gjendemi përballë fakteve sa kokëforta aq dhe të rëndësishme për të kuptuar në të vërtetë gjendjen ku jemi.

Në vjeshtën e vitit 2014, Shqipëria mori statusin e vendit kandidat dhe gjasat ishin të mira që me pak punë vendit mund t'i hapeshin negociatat dhe kështu të niste rrugën e tij treni më i rëndësishëm i procesit të integrimit. Më i rëndësishmi, pasi hapja e negociatave, është një proces i lodhshëm, por njëkohësisht fitimprurës për vendin si në aspektin ekonomik-financiar, por edhe në aspektin e ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimit shumë cilësor të legjislacionit. Me pak fjalë, Shqipëria do të ishte e gatshme të bashkohej me familjen europiane, si në aspektin e cilësisë së legjislacionit, kapaciteteve njerëzore, por edhe nga pikëpamja ekonomiko-financiare.

Po pse ndodhen vonesat dhe pse vetoja bullgare ndaj Maqedonisë së Veriut është një pretekst, pasi ne nuk i kemi përmbushur kërkesat e të BE-së. Për të sqaruar më mirë këtë pyetje, duhet t'i kthehem historisë së shkurtër të këtyre viteve. Mbas lajmit të gëzueshëm të vjeshtës së 2014, Brukseli shtroi si kërkesë kryesore luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, që në pikëpamjen europiane do të realizohej nëpërmjet reformës në drejtësi. Mbas shumë përpjekjeve, negociatave, presioneve më në fund në korrikun e 2016 Reforma në Drejtësi u miratua me 140 vota. Në fakt për çdo njëri vjeshta e këtij viti do të ishte momenti më i përshtatshëm për të hapur negociatat, por në skenë doli Holanda dhe Danimarka, të cilat si vende anëtare kanë të drejtën e vetos në këtë proces. Këto dy vende, dolën kundër hapjes së negociatave, pasi ata e cilësonin luftën që ben qeveria ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit si shumë të vakët. Viti pas ardhës 2017 përsëri kemi të njëjtin pozicion nga Holanda, që në fakt kërkonte edhe ritme më të shpejta të zbatimit të reformës në drejtësi. Ky vit përkonte dhe me zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, zgjedhje edhe pse kishte përmirësime, raporti i OSBE-ODHIR, i cilësonte me përparim të kufizuar dhe me problematika në shit-blerjen e votave, ndikim të qeverisë në fushatën zgjedhore, etj. Nuk zgjati shumë dhe në

skenë doli përgjimi i famshëm i gazetës gjermane "Bild", që faktonte me detaje raportin e OSBE-ODHIR. Pra edhe në 2018, nuk mund të na hapeshin negociatat, pasi ngelnim në klasë në elementin bazë të kërkesave europiane, zgjedhjet e rregullta dhe të ndershme.

Vjeshta e një viti më vonë, 2019, nxorri në skenë kërkesën e franceze për ndryshim të metodologjisë së zgjerimit. Në thelb ajo cfarë propozonin francezët ishte që në rast se një vend që është në procesin e negociatave nuk performon në bazë të kriterëve dhe vlerave europiane, atehere ato do të ndalonin. Meraku francez ishte kryesisht tek zgjedhjet dhe shteti i së drejtës.

Tashmë pas miratimit të propozimit francez, gjerat dukeshin se po shkonin në rrugën e duhur, Shqipëria së bashku me Maqedoninë e Veriut do të përfitonin nga hapja e negociatave në vitin 2020. Duhet thënë se dy vendet nuk janë parë asnjehere të ndara në Bruksel prandaj dhe fati i tyre është i pandarë. Në skenë del Bullgaria, e cila vendos kushte ndaj Maqedonisë së Veriut që lidhen me historinë dhe identitetin kombëtar. Duhet të theksojmë që qeveria bullgare e Boyko Borisov, miraton edhe një ligj në parlament ku vendosen kushtet për Maqedoninë e Veriut. Vetoja bullgare vazhdon dhe përgjatë 2021 dhe 2022, por pyetja kryesore është se pse Bullgaria përdor metodologjinë e re franceze dhe në këtë mënyre hap negociatat për dy vendet dhe ruan edhe interesat e saja kombëtare? A mundet Franca, Gjermania apo edhe ndonjë vend tjetër jashtë BE-së, si SHBA-ja, ta detyrojë Sofien zyrtare të heqë veton ndaj Maqedonisë së Veriut?

Po cila është arsyeja e vërtetë e kësaj vetoje? Sigurisht, që mbas kësaj vetoje, qëndron mos dëshira e elitave politike të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për të mos integruar vendet e tyre në BE. Prandaj, Gjermania, Franca dhe SHBA, kanë përdorur këtë pretekst për të ndërgjegjësuar qytetarët e këtyre dy vendeve që është koha për të ndryshuar elitat politike, pasi po të vazhdohet kështu procesi i integritimit europian është i dështuar. Janë këto elita politike, që në 30 vjet në Shqipëri, nuk kanë mundur zgjedhje të lira dhe të ndershme, raportet e OSBE-ODHIR e thonë qartazi këtë. Janë këto elita politike që kanë kthyer vendin në një nga më të korruptuarit dhe me krim të organizuar shqetsues, si dhe janë këto që kanë ngadalësuar zhvillimin ekonomik duke krijuar monopole.

Pse tani? Në fakt asgjë nuk ka ndryshuar as në Shqipëri e as në Maqedoninë e Veriut, por kemi një ndryshim në aspektin gjeopolitik në Europë. Data 24 shkurt solli sulmin rus mbi Ukrainë dhe kjo bëri që tashmë Europa dhe SHBA të ndryshojnë disa qasje. Kështu Ukraina dhe Moldavia moren statusin e vendeve kandidate me një proces të përshpejtuar, e dyta situata e brendshme politike në Maqedoninë e Veriut është e komplikuar nga ndërhyrjet e vazhdueshme ruse edhe me financime direkte të forcave politike. Në një situatë të tillë, doli përsëri një propozim francez, që në fakt, sidomos pika 4 dhe 5 lënë vend për bisedime të vazhdueshme mes Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut për të zgjidhur problematikat mes tyre. Në Sofje, propozimi francez u pranua shpejt dhe cuditërisht ishte përsëri Boyko Borisov, tani më në opozitë që bëri propozimin për shfuqizimin e ligjit që vetë kishte miratuar. Tani topi ndodhet në Shkup, ku partitë e opozitës maqedonase nuk pranojnë propozimin francez edhe pse BE dhe SHBA kanë thirrje që ai të pranohet.

Gjasat janë që edhe në Shkup të gjendet një rrugë e mesme dhe propozimi francez të pranohet, dhe së shpejti dy vendet të fillojnë negociatat me tavolinën e parë që përcakton kuadrin ligjor të tyre. Por sa shpejt do të vazhdojnë me tavolinën e dytë, kjo ngelet për t'u parë, pasi edhe pse kanë kaluar disa vite Bundestagu Gjerman ka rrjeshtuar 15 kushte për Shqipërinë, e përsëri këto kushte kanë të bëjnë me shtetin e së drejtës, thellimin e reformës në drejtësi, luftën ndaj krimin të organizuar, unë nuk besoj se gjermanët harrojnë.

Ky shkrim është pjesë e serise se shkrimeve rreth integritit europian, të Institutit Shqiptar të Medias, në kuadrin e Programit të Promovimit të Tranzicionit të Republikës Çeke.